

VENDIM
Nr.594, datë 4.9.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.145, DATË 18.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË QYTETIN E KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.145, datë 18.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet lista sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
- b) Në pikën 3, të vendimit, sipërfaqja e përgjithshme nga 62 491.7 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatë) m² bëhet 62 813.9 (gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e trembëdhjetë pikë nëntë) m².
- c) Në shkronjën “b”, të pikës 3, të vendimit, sipërfaqja totale për tokën “truall” nga 369 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m² bëhet 691.2 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e një pikë dy) m².
- ç) Në pikat 3 e 4, të vendimit, vlera e përgjithshme e shpronësimit të pronarëve nga 28 944 862 (njëzet e tetë milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë bëhet 31 695 482 (tridhjetë e një milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

2. Vlera shtesë prej 2 750 620 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet) lekësh të përballohet nga “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime”, sh.a., Korçë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPONËSOHEN NGA PROJEKTI:
“PËR DISA NDYSHIME DHE SHITESA NË VKM NR. 145, DATË 18.02.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA “NDËRTIMI I IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË QYTETIN E KORÇËS”

Çmimi për pasurinë truall sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr .	Emë r	Atësi a	Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr/pasuris ë	Lloji i pronës	Njësi a	Sip.	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Vasil	Stefan	Panariti	8561	8/326	Truall	m ²	47.45	8537	405,080	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
2	Vasil	Stefan	Panariti	8561	8/327	Truall	m ²	88.75	8537	757,658	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
3	Vasil	Stefan	Panariti	8561	8/328	Truall	m ²	36	8537	307,332	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
4	Vasil	Stefan	Panariti	8561	8/351	Truall	m ²	150	8537	1,280,550	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
Shuma totale e shponësimit								322.2		2,750,620	